



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-CC-2023-21

Vendosi: Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese
Gjykatës Vidar Stensland, kryegjykatës
Gjykatës Rumen Nenkov
Gjykatëse Romina Inkuti

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 29 gusht 2023

Gjuha: Anglishte

Titulli i dosjes: Kërkesë Referuese e Pjetër Shalës drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Shkeljen e të Drejtave Themelore të z. Shala të Garantuara nga Nenet 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës së Kosovës dhe Nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën Referuese të Pjetër Shalës drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Shkeljen e të Drejtave Themelore të z. Shala të Garantuara nga Nenet 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës së Kosovës dhe Nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

Parashtruesit

Pjetër Shala

Ushtruesit të Detyrës së

Zëvendësprokurorit të Specializuar

Vard Ferdinandse

Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese

E përbërë nga

Vidar Stensland, Kryegjykatës

Rumen Nenkov, gjykatës

Romina Inkuti, gjykatëse

pas diskutimit pa prani fizike, merr këtë vendim

I. PROCEDURA

A. KËRKESA REFERUESE

1. Më 11 korrik 2023, z. Pjetër Shala ("parashtruesi") i dorëzoi Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("Dhoma")¹ një kërkesë referuese, të datës 10 korrik 2023 ("Kërkesa Referuese"),² në bazë të neneve 31, 32, 54 dhe 113(7) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Kushtetuta"), nenit 49(3) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), si edhe të rregullave 4(c) dhe 20 të Rregullores së Punës të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("Rregullorja e DHSGJK-së"). Parashtruesi u përfaqësua nga z. Zhan-Lui Zhilisen, z. Hedi Auini dhe znj. Leto Kariolu.

2. Në Kërkesën Referuese, parashtruesi ankohet për shkelje të të drejtave të tij themelore në lidhje me procesin penal kundër tij që po zhvillohet në Dhomat e Specializuara ("DHS"). Në veçanti, parashtruesi pretendon se konstatimi i Trupit Gjykues se deklaratat që ai i dha Policisë Gjyqësore Federale Belge në vitin 2016 ("intervista e 2016-ës në Belgjikë") nuk ishin të papranueshme si prova, si edhe refuzimi i mëpasshëm i Trupit Gjykues për ta rishikuar konstatimin e tij, shkelën të

¹ KSC-CC-2023-21, F00003, Vendim për Caktimin e Gjykatësve të Panelit të Gjykatës Kushtetuese, 14 korrik 2023, konfidencial, riklasifikuar si publik më 26 korrik 2023.

² KSC-CC-2023-21, F00001, Kërkesë Referuese drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Shkeljen e të Drejtave Themelore të z. Shala të Garantuara nga Nenet 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës së Kosovës dhe Nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, 11 korrik 2023, konfidencial, riklasifikuar si publik më 20 korrik 2023 ("Kërkesa Referuese").

drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të drejtën e tij për mjet juridik efektiv sipas neneve 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe neneve 6 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (“Konventa”).³

3. Gjithashtu, parashtruesi i ka kërkuar Dhomës edhe që të pezullojë përkohësisht procesin penal që po zhvillohet kundër tij në bazë të nenit 116(2) të Kushtetutës.⁴

B. PARASHTRIMET ME SHKRIM, SHQYRTIMI I KËRKESËS REFERUESE DHE SEANCA

4. Dhoma ka konsideruar se Kërkesa Referuese ishte mjaftueshmërisht e plotë dhe se nuk ishin të nevojshme parashtrime me shkrim sipas rregullës 15(2)-(3) të Rregullores së DHSGJK-së.

5. Rrjedhimisht, Dhoma do të bëjë shqyrtimin e Kërkesës Referuese, duke u mbështetur në vetë Kërkesën Referuese dhe në dokumentet e përmendura në të. Ky vendim u referohet fakteve të çështjes gjyqësore dhe parashtrimeve të parashtruesit për aq sa janë relevante për vlerësimin e Kërkesës Referuese nga Dhoma.

6. Sa i takon kërkesës së parashtruesit për të mbajtur një seancë,⁵ Dhoma gjykon se mund të marrë vendim në lidhje me Kërkesën Referuese pa pasur nevojë për një seancë. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit për mbajtjen e një seance rrëzohet në bazë të rregullës 15(4) të Rregullores së DHSGJK-së.

II. FAKTET

A. PROCESI GJYQËSOR

7. Parashtruesi aktualisht është duke u gjykuar para një trupi gjykues të gjykatës themelore të DHS-së për krime lufte të cilat pretendohet se janë kryer midis së paku

³ Kërkesa Referuese, para. 1-3, 25-37, 39.

⁴ Kërkesa Referuese, para. 41.

⁵ KSC-CC-2023-21, F00001, para. 38.

17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999 në Kosovë dhe në zona të Shqipërisë Veriore.⁶

8. Më 20 shtator 2022, parashtruesi i dorëzoi një kërkesë Trupit Gjykses me të cilën kërkonte, mes të tjerash, përjashtimin nga dosja e çështjes e deklaratave të dhëna prej tij gjatë intervistës së 2016-ës në Belgjikë, përpara arrestimit dhe gjykimit të tij para DHS-së.⁷

9. Më 6 dhjetor 2022, Trupi Gjykses lëshoi një vendim në të cilin vendosi, ndër të tjera, se deklaratat e dhëna nga parashtruesi në kuadër të intervistës së 2016-ës në Belgjikë nuk ishin të papranueshme si prova në procesin penal kundër tij që po zhvillohet në DHS (“Vendimi mbi Deklaratat e Mëparshme”).⁸

10. Më 24 janar 2023, Trupi Gjykses miratoi kërkesën e parashtruesit për leje për të apeluar disa pika të caktuara të Vendimit mbi Deklaratat e Mëparshme, ndër të cilat, nëse Trupi Gjykses kishte bërë gabim faktik dhe juridik kur konstatoi se parashtruesi ishte informuar mjaftueshëm për natyrën dhe shkakun e dyshimit kundër tij si edhe për të drejtën për të pasur avokat gjatë intervistës së 2016-ës në Belgjikë.⁹

B. APELI I NDËRMJETËM

11. Më 6 shkurt 2023, parashtruesi apeloj Vendimin mbi Deklaratat e Mëparshme.¹⁰

12. Më 5 maj 2023, Paneli i Gjykatës së Apelit lëshoi vendimin në lidhje me apelin e parashtruesit kundër Vendimit mbi Deklaratat e Mëparshme, të cilin e miratoi pjesërisht, duke konstatuar se Trupi Gjykses kishte gabuar kur gjykoi se parashtruesi

⁶ KSC-BC-2020-04, F00007/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Pjetër Shalës, 12 qershor 2020, publik (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 6 maj 2021), para. 93, 101, 106, 111, 140(a).

⁷ KSC- BC-2020-04, F00281/RED, Version i Redaktuar Publik i Mocionit për Përjashtimin e Provave nga Dosja e Çështjes Gjyqësore që do t'i Kalohet Trupit Gjykses, 20 shtator 2022, publik (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 18 janar 2023), me Shtojcat 1-3, konfidenciale.

⁸ KSC-BC-2020-04, F00364/COR/RED, Version i Redaktuar Publik i Versionit të Korrigjuar të Vendimit në lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë nga Pjetër Shala, 6 dhjetor 2022, publik (versioni publik i redaktuar dhe i korrigjuar u dorëzua më 26 janar 2023) (“Vendimi mbi Deklaratat e Mëparshme”).

⁹ KSC-BC-2020-04, F00401, Vendim mbi Kërkesën për Leje për Apelim të Vendimit në lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë nga Pjetër Shala, 24 janar 2023, publik, para. 6(iii), 43, 73(a).

¹⁰ KSC-BC-2020-04, IA006/F0002, Apeli i Mbrojtjes kundër Vendimit në lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë nga Pjetër Shala, 6 shkurt 2023, publik.

ishte informuar mjaftueshëm për të drejtën për të pasur avokat gjatë intervistës së 2016-ës në Belgjikë (“Vendimi i Panelit të Apelit”).¹¹ Mirëpo, duke qenë se nuk gjeti tregues të mungesës së besueshmërisë, apo të cenimit të mundshëm të integritetit të procedurave në qoftë se intervista e 2016-ës në Belgjikë pranohet si provë, Paneli i Gjykatës të Apelit e konfirmoi vendimin e Trupit Gjykues për ta konstatuar intervistën e 2016-ës në Belgjikë si jo të papranueshme në përputhje me rregullën 138(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”).¹²

C. KËRKESA PËR RISHIKIM

13. Më 18 maj 2023, parashtruesi dorëzoi një kërkesë me të cilën i kërkoi Trupit Gjykues të rishikonte Vendimin mbi Deklaratat e Mëparshme në bazë të konstatimeve në Vendimin e Panelit të Apelit, si edhe një kërkesë për një vendimmarrje të shpejtuar në këtë aspekt (“Kërkesa për Rishikim”).¹³

14. Më 23 maj 2023, Trupi Gjykues mori vendim me të cilin rrëzoi kërkesën e parashtruesit për vendimmarrje të shpejtuar në lidhje me Kërkesën për Rishikim.¹⁴

15. Më 6 qershor 2023, në një vendim të lëshuar gojarisht, Trupi Gjykues rrëzoi edhe Kërkesën për Rishikim të parashtruesit.¹⁵

III. SHKELJET E PRETENDUARA

16. Parashtruesi u ankua para Dhomës se të drejtat e tij në bazë të neneve nenet 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe neneve 6 dhe 13 të Konventës u shkelën kur Trupi

¹¹ KSC-BC-2020-04, IA006/F00007, Vendim mbi Apelin e Shalës kundër Vendimit në lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë, 5 maj 2023, publik, (“Vendimi i Panelit të Apelit”), para. 72-78, 109.

¹² Vendimi i Panelit të Apelit, para. 79-81, 109.

¹³ KSC-BC-2020-04, F00515, Kërkesë e Mbrojtjes për Rishikim të Vendimit në lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë nga Pjetër Shala, 18 maj 2023, publik.

¹⁴ KSC-BC-2020-04, F00520, Vendim në lidhje me Kërkesën e Mbrojtjes për Vendimmarrje të Përshpejtuar mbi Kërkesën për Rishikim të Vendimit në lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë nga Pjetër Shala, 23 maj 2023, publik.

¹⁵ KSC-BC-2020-04, Transkripti i seancës, 6 qershor 2023, publik, f. 1938, rreshti 14 deri f. 1939, rreshti 25.

Gjykues: (i) vendosi se deklaratat e dhëna prej tij gjatë intervistës së 2016-ës në Belgjikë nuk janë të papranueshme si prova dhe mund të përdoren në funksion të aktgjykimit si edhe në funksion të rishikimit të paraburgimit; dhe (ii) rrëzoi Kërkesën për Rishikim të dorëzuar prej tij pas Vendimit të Panelit të Apelit.¹⁶

IV. JURIDIKSIONI

17. Dhoma vëren se parashtruesi e paraqiti Kërkesën Referuese në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës dhe ka parashtruar ankesa në lidhje me procesin e zhvilluar kundër tij para DHS-së. Rrjedhimisht, Kërkesa Referuese ka të bëjë me DHS-në dhe me Zyrën e Prokurorit të Specializuar, siç e kërkon neni 162(3) i Kushtetutës dhe nenet 3(1) dhe 49(2) të Ligjit. Për këtë arsye, Dhoma ka juridiksion të marrë vendim në lidhje me Kërkesën Referuese.

V. PRANUESHMËRIA

A. TË DREJTAT KUSHTETUESE NË DISKUTIM

18. Sikurse vërehet më lart, ankesat e parashtruesit kanë të bëjnë me nenet 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe nenet 6 dhe 13 të Konventës. Dhoma rikujton se, në bazë të nenit 22(2) të Kushtetutës, garancitë e parashikuara në Konventë gjejnë zbatim në nivel kushtetues.¹⁷ Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka ritheksuar se të drejtat dhe liritë e garantuara nga instrumentet ndërkombëtare të përmendura në nenin 22 të Kushtetutës “kanë statusin e normave të rendit kushtetues dhe janë pjesë integrale e Kushtetutës, në të njëjtën mënyrë si të gjitha dispozitat e tjera të Kushtetutës”.¹⁸ Duke

¹⁶ Kërkesa Referuese, para. 1-3, 25-37, 39.

¹⁷ Shih KSC-CC-2022-13, F00010; KSC-CC-2022-14, F00009, Vendim mbi Kërkesën Referuese të Jakup Krasniqit në lidhje me Ligshmërinë e Akuzës së Ndërmarrjes Kriminale të Përbashkët dhe Kërkesën Referuese të Kadri Veselit në lidhje me Vendimin e Panelit të Apelit për Kundërshtimet ndaj Juridiksionit të Dhomave të Specializuara, 13 qershor 2022, publik (“Vendimi mbi Kërkesën Referuese të Krasniqit dhe Veselit”), para. 34, me referenca të mëtejshme.

¹⁸ Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimeve* [A.A.U.ZH. nr. 20/2019 datë 30 tetor 2019; dhe A.A.U.ZH. nr. 21/2019, datë 5 nëntor 2019] të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, KI 207/19, Aktgjykim, 10 dhjetor 2020 (5 janar 2021), para. 111.

pasur parasysh sa më lart, Dhoma konstaton se Kërkesa Referuese shqyrtohen në kuadër të neneve 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe neneve 6 dhe 13 të Konventës.¹⁹

19. Megjithatë, përpara se Dhoma të mund të shqyrtojë themelësinë e Kërkesës Referuese, ajo së pari duhet të përcaktojë nëse Kërkesa Referuese është e pranueshme.²⁰ Kjo rrjedh nga neni 113(1) i Kushtetutës, sipas të cilit Dhoma vendos vetëm në lidhje me çështje “të ngritura para [saj] në mënyrë të ligjshme nga palë të autorizuar”.²¹ Gjithashtu, rregulla 15(1) e Rregullores së DHSGJK-së parashikon se Dhoma merr vendim në lidhje me “pranueshmërinë dhe/ose themelësinë e një referimi të bërë në bazë të nenit 49 të Ligjit”. Për rrjedhojë, Dhoma duhet së pari të vlerësojë *ex officio* nëse Kërkesa Referuese është e pranueshme ose jo.²² Pra, Dhoma do të trajtojë tani aspektin e pranueshmërisë.

B. A JANË TË PARAKOHSHME ANKESAT E PARASHTRUESIT

20. Dhoma rikujton se në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës dhe nenit 49(3) të Ligjit, individët janë të autorizuar t'i drejtohen Dhomës [lidhur me] shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive të tyre individuale të garantuara me Kushtetutë. Kjo parashikohet edhe në rregullën 20(1) të Rregullores së DHSGJK-së. Në këtë aspekt, Dhoma vëren se rregulla 14(f) e Rregullores së DHSGJK-së përcakton se referimi është

¹⁹ Shih, mes të tjerash, *Vendimin mbi Kërkesën Referuese të Krasniqit dhe Veselit*, para. 35.

²⁰ KSC-CC-2022-15, F00010, *Vendim mbi Kërkesën Referuese të Hashim Thaçit lidhur me të Drejtën për një Gjykatë të Pavarur dhe të Paanshme të Themeluar me Ligj dhe për Mendim të Arsytuar*, 13 qershor 2022, publik (“*Vendimi mbi Kërkesën Referuese të H. Thaçit lidhur me Kundërshtimin e Juridiksionit*”), para. 42. Shih edhe *Vendimin mbi Kërkesën Referuese të Krasniqit dhe Veselit*, para. 36.

²¹ KSC-CC-2022-19, F00004/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën Referuese të Pjetër Shalës në lidhje me të Drejtat Themelore të Garantuara nga Nenet 31 dhe 32 të Kushtetutës së Kosovës dhe Nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, 15 dhjetor 2022, publik (“*Vendimi mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës lidhur me të Drejtën për Gjykim të Drejtë dhe Mjete Juridike*”), para. 14; *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të H. Thaçit lidhur me Kundërshtimin e Juridiksionit*, para. 42. Shih dhe Kosovë, *Gjykata Kushtetuese, Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit Ae nr. 287/18 të 27 majit 2019 dhe Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, I.EK .nr. 330/2019, të 1 gushtit 2019, KI 195/19, Aktgjykim, 5 maj 2021 (31 maj 2021), para. 68-69; Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 313/2018, të 10 dhjetorit 2018, KI 12/19, Aktvendim për Papranueshmëri, 10 prill 2019 (3 maj 2019), para. 30-31.*

²² *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës lidhur me të Drejtën për Gjykim të Drejtë dhe Mjete Juridike*, para. 14; *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të H. Thaçit lidhur me Kundërshtimin e Juridiksionit*, para. 42-43.

i papranueshëm në qoftë se asgjë në referim nuk krijon përshtypjen e një shkeljeje të një të drejte kushtetuese.

21. Dhoma vëren se procesi penal kundër parashtruesit nuk ka përfunduar ende dhe se për akuzat e ngritura nuk është marrë ende vendim. Rrjedhimisht, Dhoma duhet të së pari të konstatojë nëse parashtruesi, në këtë fazë të procesit penal, mund të ngrejë pretendim se është viktimë e shkeljeve të pretenduara.²³

1. A mund të pretendojë parashtruesi se është viktimë

(a) Parashtrimet

22. Parashtruesi argumenton se Kërkesa Referuese është e pranueshme. Në veçanti, ai pretendon se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion pas Vendimit të Panelit të Apelit që konfirmoi Vendimin e Trupit Gjykses mbi Deklaratat e Mëparshme.²⁴ Parashtruesi argumenton gjithashtu se ishte viktimë e drejtpërdrejtë e shkeljeve të pretenduara të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të drejtës për mjet juridik efektiv në bazë të neneve 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe neneve 6 dhe 13 të Konventës, si rezultat i Vendimit të i Trupit Gjykses mbi Deklaratat e Mëparshme dhe rrëzimit të mëpasshëm të Kërkesës së tij për Rishikim të Vendimit.²⁵ Së fundi, parashtruesi pretendon se e kishte dorëzuar Kërkesën Referuese brenda dy muajve pas Vendimit të Panelit të Apelit (shih paragrafin 12 më lart) dhe rrëzimit të Kërkesës së tij për Rishikim nga Trupi Gjykses (shih paragrafin 15 më lart).²⁶

²³ Shih, mes të tjerash, KSC-CC-2022-18, F00004/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën Referuese të Pjetër Shalës drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me të Drejtat Themelore të Garantuara nga Nenet 30 dhe 31 të Kushtetutës së Kosovës dhe Neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, 22 gusht 2022, publik ("*Vendimi mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës lidhur me të Drejtën për Qasje në Material*"), para. 15; *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të Krasniqit dhe Veselit*, para. 38.

²⁴ Kërkesa Referuese, para. 19-20.

²⁵ Kërkesa Referuese, para. 19, 21-22.

²⁶ Kërkesa Referuese, para. 19.

(b) Vlerësimi i Dhomës

23. Fillimisht, Dhoma mban parasysh faktin se ankesa e parashtruesit ka të bëjë në thelb me: (i) një shkelje të pretenduar të së drejtës së parashtruesit për gjykim të drejtë si pasojë e konstatimeve të Trupit Gjykses se deklaratat e dhëna prej tij gjatë intervistës së 2016-ës në Belgjikë nuk janë të papranueshme si prova; dhe (ii) mungesën e pretenduar të një mjeti juridik efektiv në këtë aspekt.²⁷ Dhoma vëren më tej se, megjithëse neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës garantojnë të drejtën e gjykimit të drejtë, në asnjë prej tyre nuk përcaktohen rregulla të mirëfillta mbi pranueshmërinë e provave, që, në kontekstin e DHS-së, është aspekt që rregullohet nga Ligji dhe nga Rregullorja dhe dhomat penale përkatëse.²⁸ Konkretisht, ky aspekt rregullohet me rregullën 138 të Rregullores , dhe u vlerësua si nga Trupi Gjykses,²⁹ ashtu edhe nga Paneli i Gjykatës të Apelit.³⁰

24. Rrjedhimisht, nuk është pjesë e rolit të Gjykatës Kushtetuese që të vendosë, në parim, nëse lloje të caktuara provash mund të jenë ose jo të pranueshme. Në vend të kësaj, pyetja së cilës duhet t'i japë përgjigje Dhoma është nëse procesi, në tërësi, nëse ka qenë ose jo i drejtë, përfshirë mënyrën e marrjes së provave.³¹ Në këtë kuadër, Dhoma rikujton se, megjithëse konstatoi se do t'i ketë në dispozicion deklaratat e dhëna gjatë intervistës së 2016-ës në Belgjikë në funksion të aktgjykimit, Trupi Gjykses ende nuk i ka përdorur ato për të marrë vendim mbi akuzat e ngritura kundër parashtruesit.³² Megjithatë, Dhoma vëren se Trupi Gjykses i ka përdorur këto

²⁷ Kërkesa Referuese, para. 26-31, 32-37.

²⁸ Krahaso: ECtHR, *Moreira Ferreira v. Portugal* (No. 2) [GC], no. 19867/12, 11 July 2017, para. 83. Shih edhe Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Pml. Nr. 199/2018, të 5 dhjetorit 2018*, KI 63/19 dhe KI 66/19, Aktvendim për papranueshmëri, 12 prill 2021 (26 prill 2021), para. 100 (në gjuhën shqipe) ("*Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Pml. Nr. 199/2018*").

²⁹ Vendimi mbi Deklaratat e Mëparshme, para. 19-21, 67-79.

³⁰ Vendimi i Panelit të Apelit, para. 70-81.

³¹ ECtHR, *Ayetullah Ay v. Turkey*, nos 29084/07 and 1191/08, 27 October 2020, para. 124; *Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Pml. Nr. 199/2018*, para. 101.

³² Vendimi mbi Deklaratat e Mëparshme, para. 80, 114(c). Shih gjithashtu KSC-BC-2020-04, F00491/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave Dokumentare, 20 prill 2023, publik, para. 40-41.

deklarata në vijimësi në kontekstin e rishikimit të paraburgimit. Sidoqoftë, Paneli vëren se parashtruesi nuk ka bërë ankesë në bazë të nenit 29 të Kushtetutës dhe nenit 5 të Konventës, as në këtë Kërkesë Referuese, as gjetkë.

25. Krahas sa më lart, Dhoma vëren se procesi penal kundër parashtruesit nuk ka përfunduar ende dhe se akuzat në fjalë ende duhet të shqyrtohen në tërësi dhe për to të merret vendim nga Trupi Gjykes dhe, sipas rastit, paneli i Gjykatës së Apelit dhe paneli i Gjykatës Supreme, në përputhje me kompetencat e tyre përkatëse. Duke qenë se parashtruesi ankohet për drejtësinë e një procesi që nuk ka përfunduar, rezultati i tij mund të jetë relevant për të përcaktuar nëse parashtruesi mund të pretendojë se është viktimë e shkeljes së pretenduar të të drejtave të parashikuara në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës.³³

26. Dhoma rikujton jurisprudencën e afirmuar të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ("GJEDNJ"), si çështjet *Sakhnovskiy v. Russia* [GC] dhe *Oleksy v. Poland*, mes të tjerash, në të cilat GJEDNJ-ja u shpreh se një individ nuk mund të pretendojë se është viktimë e një shkeljeje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë në bazë të nenit 6 të Konventës kur procesi është ndërprerë apo kur individ i është shpallur i pafajshëm.³⁴ Përrjashtime të kufizuara ndaj këtij parimi përfshijnë, për shembull, ankesat që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e arsyeshme të procesit dhe të drejtën për gjykim të drejtë.³⁵

27. Faktikisht, u takon së pari dhomave penale të vlerësojnë nëse pretendimi i ngritur për shkelje procedurale ka ndonjë bazë dhe nëse kjo duhet ndrequr në proceset në vijim.³⁶ Kjo pasqyron parimin e përgjithshëm sipas të cilit përmbushja e kriterëve

³³ *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës lidhur me të Drejtën për Qasje në Material*, para. 17. Shih edhe *Vendimin mbi Kërkesën Referuese të H. Thaçit lidhur me Kundërshtimin e Juridiksionit*, para. 60.

³⁴ ECtHR, *Sakhnovskiy v. Russia* [GC], no. 21272/03, 2 November 2010, para. 77 ("*Sakhnovskiy v. Russia*"); *Oleksy v. Poland*, no. 1379/06, 16 June 2009. Shih edhe *Vendimin mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës lidhur me të Drejtën për Qasje në Material*, para. 18; *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të H. Thaçit lidhur me Kundërshtimin e Juridiksionit*, para. 60.

³⁵ *Sakhnovskiy v. Russia*, para. 77; ECtHR, *Osmanov and Husseinov v. Bulgaria* (dec.), nos 54178/00 and 59901/00, 4 September 2003. Shih edhe *Vendimin mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës lidhur me të Drejtën për Qasje në Material*, para. 18.

³⁶ *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës lidhur me të Drejtën për Qasje në Material*, para. 19, ku i referohet ECtHR, *Mehmet Zeki Çelebi v. Turkey*, no. 27582/07, 28 January 2020, para. 51.

të gjykimit të drejtë duhet të shqyrtohet në secilin rast duke mbajtur parasysh zhvillimin e procesit në tërësi dhe jo në bazë të shqyrtimit të izoluar të një aspekti të veçantë apo të një incidenti të vetëm procedural, përpos rastit kur, pas marrjes së vendimit për akuzat e ngritura dhe përfundimit të procesit nga dhoma penale, mund të konstatohet që, një faktor i veçantë, qoftë edhe një i cili ndikoi në fazat e hershme të procesit, ka qenë aq vendimtar saqë e bën automatikisht procesin në tërësi të padrejtë.³⁷ Në këtë aspekt, Dhoma vëren gjithashtu se jurisprudenca e GJEDNJ-së në të cilën mbështetet parashtruesi, ku trajtohen shkelje të pretenduara të së drejtës për përfaqësim juridik në bazë të nenit 6 të Konventës, ka të bëjë me pyetjen nëse procesi në tërësi kishte qenë i drejtë, pas përfundimit të tij.³⁸

28. Rrjedhimisht, në këtë fazë të procesit, parashtruesi nuk mund të pretendojë se është viktimë e një shkeljeje të pretenduar të së drejtës së tij për gjykim të drejtë sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës. I njëjti përfundim vlen edhe për shkeljen e pretenduar të neneve 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe nenit 13 të Konventës, duke qenë se e drejta për mjet juridik nuk ekziston në mënyrë të pavarur dhe mund të zbatohet vetëm në kombinim me shkeljen e pretenduar të një tjetër të drejte tjetër në lidhje me të cilën individi ka një pretendim të arsyeshëm.³⁹

2. Përfundim

29. Dhoma konstaton për rrjedhojë se, në këtë fazë të procesit, Kërkesa Referuese është e parakohshme.⁴⁰ Rrjedhimisht, ankesat e parashtruesit në bazë të neneve 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe neneve 6 dhe 13 të Konventës duhen shpallur të papranueshme sipas nenit 113(7) të Kushtetutës, nenit 49(3) të Ligjit dhe rregullës 14(f)

³⁷ ECtHR, *Ibrahim and others v. the United Kingdom* [GC], no 50541/08 and others, 13 September 2016, para. 250-251, 254.

³⁸ Kërkesa Referuese, para. 27. Shih edhe, përgjithësisht, ECtHR, *Çimen v. Turkey*, no. 19582/02, 3 February 2009; *Panovits v. Cyprus*, no. 4268/04, 11 December 2008.

³⁹ Shih, për shembull, ECtHR, *Maurice v. France* [GC], no. 11810/03, 6 October 2005, para. 106; *Zavoloka v. Latvia*, no. 58447/00, 7 July 2009, para. 35(a).

⁴⁰ Krahaso: *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të H. Thaçit lidhur me Kundërshtimin e Juridiksionit*, para. 65; *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të Krasniqit dhe Veselit*, para. 55.

të Rregullores së DHSGJK-së.

30. Së fundi, ndonëse Dhoma konstaton se Kërkesa Referuese duhet rrëzuar për arsyet e lartpërmendura, ajo rikujton se korniza ligjore e DHS-së i lejon parashtruesit të ngrejë pretendime për shkelje të të drejtave që i takojnë sipas neneve 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe neneve 6 dhe 13 të Konventës në faza të ndryshme të ardhshme të procesit, përfshirë me anë të një apeli kundër aktgjykimit të Trupit Gjykes sipas nenit 46 të Ligjit. Në lidhje me këtë, Dhoma vëren gjithashtu se sipas nenit 113(7) të Kushtetutës, nenit 49(3) të Ligjit dhe rregullës 20(1)(a) të Rregullores së DHSGJK-së, një individ mund t'i drejtojë kërkesë referuese Dhomës vetëm pasi ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të parashikuara me ligj kundër shkeljes së pretenduar.

31. Mbështetur në sa më lart, duhet rrëzuar edhe kërkesa e parashtruesit për të urdhëruar pezullim të procesit penal kundër tij.

PËR KËTO ARSYE,

Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, njëzëri,

1. *E shpall* Kërkesën Referuese të z. Pjetër Shala të papranueshme; dhe
2. *Rrëzon* Kërkesën Referuese në tërësi.

/nënshkrimi/

Vidar Stensland
Kryegjykatës

Hartuar në anglishte të martën, më 29 gusht 2023
Në Hagë, Holandë